“Mos hyni në vendbanimet e atyre që i kanë bërë zullum vetes (gjë për të cilën u dënuan), përveçse duke qarë

Abdullah Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Kaluam me të Dërguarin e Allahut nga Hixhri (vendbanimi i themudëve) dhe në atë rast i Dërguari i Allahut na tha: “Mos hyni në vendbanimet e atyre që i kanë bërë zullum vetes (gjë për të cilën u dënuan), përveçse duke qarë, nga droja që të mos ju godasë ajo që i ka goditur ata.” Pastaj i mësyu kafshës dhe shpejtoi, derisa e la vendbanimin e tyre pas vetes.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Kur kaloi pranë vendbanimit të themudëve, Profeti ndaloi hyrjen në banesat e atyre njerëzve të ndëshkuar që i kishin bërë padrejtësi vetes, ose vizitimin e tyre, përveç nëse ai që hyn është duke qarë dhe duke medituar për fatin e tyre, nga frika se mos i njëjti ndëshkim që i goditi ata mund ta godasë edhe atë. Pastaj i grahu devesë dhe shpejtoi, derisa e la vendbanimin e tyre pas vetes.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/66294